



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC

Nr. 1487 Prot.

Pogradec, më 09.04.2025

VENDIM

Nr. 92, datë 09.04.2025

**RREGULLAT DHE KRITERET E NDARJES SË HAPËSIRAVE REKLAMUESE
ZGJEDHORE NË BILLBORDE DHE CITY LIGHTS NË MËNYRË TË BARABARTË**

Në zbatim të Ligjit nr.139/2015 Per Vetëqeverisjen Vendore, nenit 19, pika 1, shkronja “ë” dhe “n”, nenit 79, pika 1, e nenit 172/1 të Ligjit Nr.10019, datë 29.12.2008 “ Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë ” i ndryshuar, të Vendimit Nr. 415 datë 08.04.2025 “ Për Rregullat dhe Kriteret e Ndarjes së Hapësirave Reklamuese Zgjedhore në Billborde dhe City Light në Mënyrë të Barabartë”

VENDOSA:

1. Hapësirat reklamuese zgjedhore “Billborde dhe City Light”, të lejuara për afishimin e materialeve propagandistike zgjedhore jane sipas listët dhe skicës si mëposhtë,
2. Operatorët e kontraktuar për reklamim janë të detyruar të zbatojnë dispozitatat e Vendimit Nr. 415, datë 08.04.2025 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve,
3. Reklamimi politik i kryer nga subjektet zgjedhore nëpërmjet citylighteve duhet të përfundojë, me fillimin e heshtjes zgjedhore, një ditë përpara ditës së mbajtjes se zgjedhjeve,
4. Subjektet zgjedhore dhe/ose kandidatët për deputetë që shkelin rregullat e caktuara në këtë vendim, do të saksionohen dhe do të detyrohen të heqin materialet e vendosura në menyrë të kundërligjshme,
5. Ngarkohet Policia Bashkiake dhe Policia e Shtetit për zbatimin e pikës 2, të këtij vendimi,
6. Vendimi bëhet publik në faqen e internetit të Bashkisë menjëherë pas miratimit.
7. Ky Vendim hyn në fuqi menjehere.

KRYETAR
Ilir XHAKOLLI

